ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 235/17
Datë/Datum 24.07.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Një ankesë kundër: ***KUVENDIT KOMUNAL PRISHTINË***

Për Aktivitetin e Prokurimit: ***616-17-1628-2-1-1, 616 17 033 211***

Sa i përket tenderit për : ***"PASTRIMI I OBJEKTEVE SHËNDETSORE"***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Schafberger Gmbh & €rik shpk & Krasniqi shpk

RR."NENA TEREZE"
GLLOGOC
13000
044/[redacted]
PETRIT LEKU
[redacted]@hotmail.com

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

24.07.2017

(Nënshkrimi)

Dega Kosovë Schafberger jr. GmbH Gllogoc

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën eshtë publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

- *Njoftimi per Kontrate 08.05.2017*
- *Njoftimi për dhënie të kontratës 10.07.2017*
- *Afati i fundit per dorzimin e tenderve 05.06.2017*
- *Hapja e dosjeve te tenderit 05.06.2017*
- *Kriteri per dhenje te kontates:..... Tenderi i pergjegjshem me çmimin me te ulet*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] Jo [ ]

Hapja e tenderit është bërë me datë:05.06.2017 ora 14:30 dhe ka shkuar në rregull.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Kerkese per rishqyrtimin e vendimit mbi arsyet e eleminimit
Vendimin mbi refuzimi e kerkeses per rishqyrtimit

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **ËSHTË BËRË SHKELJA E LPP-SË NR. 04/L-042 PËR PROKURIM PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-237, LIGJIN 05/L-068 DHE LIGJIN 05/L-092.**
- **NENI - 1. QËLLIMI**
- **NENI - 2. FUSHVEPRIMI**
- **NENI - 7. BARAZIA NË TRAJTIM/ JO-DISKRIMINIMI**
- **NENI - 52. NJOFTIMI I KRTITEREVE PËR DHËNIJE TË KONTRATËS**

- NENI – 59 . EKZAMINI , VLERSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE

- NENI – 69. KËRKESAT MBI MUNDESIT TEKNIKE DHE PROFESIONALE

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Duke u bazuar në Nenin 108/A , të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikes së Kosovës,i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237 ,ligjin NR.05/L-092 , kërkojmë nga ju që në perputhje me LPP-ne ti shqyrtoni të gjitha pretendimet tona ankimore dhe na jepni pergjigjje për çdo pike ankimore siq parashihet në LPP-së .

Gjatë afatit të vlersimit të tenderëve ne me dt.20.06.2017 kemi pranuar një e-mail nga zyrtarët e AK-së, ku kërkohet dokumenti shtesë lidhur me Auto Cistern. Ne pas pranimit të email përpos marrëveshjes me Z.Sallahu që ka të bëjë me Autocisternen me targa :04-479-CI kemi dorëzuar edhe dy marrëveshje tjera për Autocistern,njera marrëveshje që ka Kompania jonë me një kompani tjetër dhe tjetra marrëveshje e Kompanisë "Krasniqi shpk" qe jemi edhe Konzorcium në këtë tender.Dy marrëveshjet e fundit nuk janë pranuar nga AK sepse është kërkuar vetem marrëveshja e AutoCisternes që e kemi prezantuar në dosjen e tenderit.Pas pranimit të Marrëveshjes me Z.Sallahu zyrtarët e prokurimi kanë pohuar se gjithëqka është në rregull,kjo marrëveshje është e vlefshme duke e pranur marrëveshjen origjinale që është dorzuar nga Ne si dhe na është thënë që nese nuk jemi të interesuar për tender të terhiqemi.Pas dy javе qe na eshte pranuar dokumenti i kërkuar është shpallur fituese Kompania me qmim më të shtrejt.

Edhe perkunder prezantimit te pajisjes Auto Cistern, ku kemi te bashkangjitur, Marrveshjen e Bashkpunimit me personin fizik z. Lulzim Sallahu te dt. 04.01.2015, ne origjinal, AK e ka kundershtuar nje dokument te tille, me arsyetimin se nuk është e noterizuar, mirpo nuk ka kuptimi një dokument origjinal të jetë i noterizuar per deri sa është origjinali, edhe pse Marrëveshja për bashkpunim për pajisje nuk është e kërkuar në FDT që të jetë e noterizuar.

Me datë 10.07.2017 kemi pranuar Letrën standarde për tenderuesin e eleminuar, me arsyetimin:

1. **Ju keni dështuar të dorëzoni listën e materialeve të kërkuara për pastrim dhe dëshmitë se ato materiale janë ekologjike,respektivisht ju keni dorëzuar një listë të materialeve në të cilën keni paraqitur vetëm pesëmbëdhjetë artikuj nga lista e artikujëve të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues(artikujt nga listat me numrat rendor 1,2,34,6,7,8,9,10,12,13,14,16,27 dhe 28),ndërsa keni ofruar dokumentin përkatës MSDS për vetëm pesë artikuj nga lista dhe atë për numrat rendor nga Lista e Autoritetit Kontraktues si vijon:4,9,10,12 dhe 13);**